TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 02/54
Dt. 18.03.2014
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

RAPORT VJETOR 2013

Vendimi: Nr. 02/54

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2013 në mbledhjen Nr. 40 të mbajtur me datë 13.03.2014

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Betim Gjoshi Kryeshef Ekzekutiv	Hasan Ibraj Kryesuesi i BD
Nënshkrimi		
Data	13.03.2014	13.03.2014

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A

RAPORT VJETOR 2013



PËRMBAJTJA:

1. Hyrje 3

2. Raport i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve 4
   - 2.1. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes 4
   - 2.2. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten 6
   - 2.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv 6
   - 2.4. Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A 7

3. Raport i Kryeshet Ekzekutiv 10
   - 3.1. Fjala e Kryeshefitt Ekzekutiv 10
   - 3.2. Ngjarjet kryesore të vitit 12
   - 3.3. Pasqyra e performancës operative 12
   - 3.4. Pasqyra e performancës finnanciare dhe rezultatet 18
   - 3.5. Progresi me planin e biznesit 23
   - 3.6. Projektet kapitale 24
   - 3.7. Perspektiva për vitin e ardhshëm 25
   - 3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës 26

4. Raporti sipas Ligjit mbi Ndërmarrje Publike 27
   - 4.1. Struktura organizative e Trainkos Sh.A 27
   - 4.2. Kontestet gjyqësore në periudhën janar-dhjetor 2013 29
   - 4.3. Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2014 29
   - 4.4. Transaksionet e realizuara 30

5. Përfundim 31

6. Aneks Raporti
   - 6.1. Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet
   - 6.2. Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2013
   - 6.3. Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

1 HYRJE

Gjatë gjithë viti 2013 kompania kishte një ecuri progresive të realizimit të planit operativ dhe financiar. Progresi ka qenë rezultat i palodhshëm i krejt ekipit të Trainkos Sh.A, ,edhe pse ndihma nga të tjerët nuk ka qenë e mjaftueshme. Vitin 2013, kompania e filloi me dokumentacionin bazë të kompletuar (Planin e Biznesit, Planin e Buxhetit dhe të gjitha politikat tjera të përcaktuara), mbi bazën e të cilave është zhvilluar aktiviteti dhe puna e kompanisë.

Hekurudhat e Kosovës janë ndërmarrja më vjetër publike në Kosove. Gjatë vitit 2014, Hekurudhat do të shënojnë 140 vjetorin e themelimit. Hekurudhat gjatë historisë se vet kanë kaluar nëpër transformime të shumta. Në shtator të vitit 2011 si nevojë e kohës kompania është ndarë në dy ndërmarrje, në Trainkos Sh.A dhe Infrakos Sh.A. Operatori i vetëm hekurudhor në Kosovë, Trainkos Sh.A si një kompani e re, në vitin e dytë të punës së tij, pra në vitin 2013 shënoi një progres të dukshëm.

Ky raport vjetor i punës për vitin 2013 ku përfshihet aktiviteti i Ndërmarrjes Publike Trainkos Sh.A do të filloj me fjalën e Kryesuesit të BD i cili bart në vete performancën e kompanisë bashkë me aktivitetet e saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë dhe politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj. Trainkos Sh.A edhe pse një kompani e re publike vijoi të kryejë funksionin e saj të përshkruar me ligj krahas konsolidimit dhe ngritjes së kapaciteteve të veta njerëzore e materiale. Në këtë vit kompania ngriti edhe infrastrukturën e nevojshme ligjore, ngriti kapacitetet menaxhuese, dhe rriti mekanizmat e kontrollit.

Në vazhdim raporti vijohet nga raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhëna për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Kur jemi te progresi drejt realizimit të planit të biznesit, raporti ynë ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Raporti për të qenë sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij përmban edhe grafikone, tabela statistikore e skema tjera me sqarime të nevojshme.

Në përpjekje të realizimit të këtij raporti, për të pasqyruar aktivitetet e kompanisë, suksesin e saj në realizimin operativ e financiar, gjithsesi që jemi bazuar edhe në udhëzuesin në lidhje me hartimin e raportit vjetor dhe po ashtu edhe në Ligjin për NP.

Raporti Vjetor 2013 i Trainkos Sh.A ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të aksionarit.

2 RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" Sh.A edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar punën e tij me përkushtim të lartë që ndërmarrja të konsolidohet sa më mirë dhe të arrij rezultatet e planifikuara. Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të këtij angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve.

Ne, në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2013.

2.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Raporti Vjetor i Punës së HK Trainkos Sh.A, gjithashtu edhe për vitin 2013 pasqyron të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Duke qenë të ndikuar nga rezultatet e vitit paraprak, të cilat nuk kanë qenë të kënaqshme, por jo të papartishme për shkaqet që tanimë janë të njohura,, viti 2013 është përmbyllur me një rezultat të lartë operativ e financiar.

Një ndër shkaqet kryesore që ka ndikuar në përmirësimin gjendjes së kompanisë është fakti se pagesat për qasje në rrjet të cilat i paguhen menaxherit të infrastrukturës, në vitin 2013 kanë qenë më të arsyeshme se ato të vitit paraprak. Gjithashtu, një politikë shtrënguese në reduktimin e shpenzimeve si dhe të shumë projekteve ka bërë që viti 2013 të rezultojë me një performancë të mirë. Kjo na bënë që mos t'i gëzohemi shumë këtij rezultati, sepse nuk do të ketë mundësi që në periudhën në vazhdim të ndiqet kjo politikë. Projektet e pezulluara duhet të fillojnë të zbatohen.

Sfidat me të cilat u ballafaquam edhe gjatë vitit 2013 ishin të ndryshme. Përderisa ishte rregulluar çështja e pagesave të qasjes në binarë, ende kanë mbetur shumë çështje tjera të pazgjidhshme. Mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve ende vazhdon të mos bëhet ashtu siç është e definuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovë. Kjo pikë do të jetë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes së re Trainkos Sh.A, gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- ## Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2013

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2013 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Falë angazhimit të vazhdueshëm të stafit të kompanisë kemi arritur që të tejkalojmë këto objektiva.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

Ndërsa, duhet theksuar se ne u përkushtuam edhe në realizimin e objektivave në fushën e bashkëpunimit me institucionet vendore e ndërkombëtare, ku mund të themi me përgjegjësi se kemi arritur të avancojmë jashtëzakonisht shumë në ndërtimin e një bashkëpunimi shumë domethënës në këtë drejtim.

- ## Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Gjatë vitit 2013 Trainkos Sh.A ka pasur një rezultat të mirë operativ e financiar, sidomos në transportin e mallrave. Sa i përket realizimit operativ të transportit të udhëtarëve edhe në këtë kategori kemi një tejkalim të realizimit të planifikuar. Por, realizimi financiar në TU ende ka mbetur i paarritshëm për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Aksionarit. Gjithashtu edhe në sektorin e mirëmbajtjes janë arritur disa prej objektivave.

Transporti i Mallrave

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për 20% neto tonë mallra të transportuara më shumë se sa planifikimi, apo për 34% më shumë se realizimi gjatë vitit 2012. Performanca financiare nga transporti i mallrave është për 26 % më shumë se planifikimi vjetor si dhe për 24 % më shumë se realizimi financiar gjatë vitit 2012.

Transporti i Udhëtarëve

Përformanca operative në këtë kategori transporti është tejkaluar për 1% në krahasim me vitin paraprak si dhe për 1% po ashtu, më shumë se planifikimi. Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave kemi pasur një rritje prej 5.5 % të të hyrave. Përkundër kësaj, shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtareve ende mbeten të pambuluara ashtu siç e parasheh Ligji për Hekurudhat. Për këtë shkak humbjet nga transporti i udhëtarëve për vitin 2013 janë -573,700.28€.

- ## Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Sfidat për vitin në vijim, si dhe për të ardhmen, mbeten sfidat për plotësimin e politikave (rregulloreve) bazike, për të cilat padyshim se duhet angazhim shtesë edhe i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe institucioneve tjera, e të cilat kanë përgjegjësinë e caktuar në këtë drejtim. Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet mbikëqyrja e punës menaxheriale si dhe përpilimi e hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim. Aspekti i strukturës së stafit të punonjësve do të jetë sfidë më vete; siç është përtëritja e stafit ku mosha mesatare e punëtorëve është tejet e lartë dhe përmirësimi i strukturës gjinore e profesionale, po ashtu. Vlen të ceket se shërbimet e veçanta që ne ofrojmë, kërkojnë edhe

përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë edhe përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante. Për këtë të fundit, kemi zhvilluar një mori takimesh e negociatash, por që për realizimin e këtij synimi, kërkohet kosto jo e vogël.

- Të priturat për vitin e ardhshëm

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve, ku kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik, shpresojmë se do të kemi sukses.

Synim tjetër, mbetet rritja e transportit të mallrave si dhe rritja e të hyrave nga transporti i udhëtarëve. Në këtë drejtim, presim që të rrisim volumin e transportit dhe njëkohësisht, tek TU, presim të hasim në mirëkuptimin e ministrisë përkatëse me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për shërbime të përbashkëta PSO konform kërkesave ligjore të parapara në Ligjin e Hekurudhave.

Si përfundim, marrë në përgjithësi nëse shikojmë trendin e zhvillimit të kompanisë, për Hekurudhat e Kosovës, Trainkos Sh.A, vitin 2013 do ta quajmë vit të përballimit të suksesshëm të sfidave të mëdha. Ndërsa, së bashku do angazhohemi që vitin 2014, me punë dhe rezultate, ta pagëzojmë si vitin model të zhvillimit dhe avancimit të Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A.

2.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Shuma e Donacionit nga Buxheti i Kosovës prej 1,000,000.00€ për projektet kapitale të parashikuara në vitin 2013, është shfrytëzuar në vlerë prej 152,716.00€, dhe mbetja e pashfrytëzuar nga BK është 847,233.55.

Është më rëndësi në këtë rast të theksohet se projektet e vitit paraprak, riparimi gjeneral i një lokomotive si dhe riparimi i mesëm i dy trenave motorikë të udhëtarëve, gjatë vitit 2013 janë realizuar dhe janë në përdorim nga kompania. Me këto mjete lëvizëse të riparuara ne ju ofrojmë qytetarëve shërbime më efikase dhe më cilësore.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Ndërmarrja "Trainkos" Sh.A, gjatë këtij viti nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë se, ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh, e që do ndikonte negativisht në operimet në vazhdim.

Ndërsa sa i përket ndarjes së **dividentës**, kompania nuk ka arritur atë nivel të performancës së vet për të realizuar atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

2.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 04/24 të datës 20.07.2011, ndërsa me Vendimin tjetër të Qeverisë me Nr. 27/53 të datës 21.12.2011 i është vazhduar mandati deri në

përzgjedhjen e Bordit të ri. Në bazë të këtij vendimi si dhe të LNP, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2013 Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" Sh.A ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Po ashtu edhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin është mbajtur sipas afatit të paraparë. Edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Bordit, numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2013 si dhe pjesëmarrja e drejtorëve në këto mbledhje:

Përbërja e Bordit të Drejtorëve të HK Trainkos Sh.A			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	kryesues	12
2	Heset Cakolli	anëtar	12
3	Labinot Halilaj	anëtar	12
4	Shkumbin Hyseni	anëtar	12
5	Betim Gjoshi	Kryeshef Ekzekutiv	12

2.4 Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A

Që nga emërimi i Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e tij e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi i Drejtorëve si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari. Disa prej komiteteve të BD, pasi që është vlerësuar se nuk janë të domosdoshme, ato edhe janë shpërberë, por në ndërkohë janë krijuar edhe komitete të reja për çështje të caktuara të cilat kanë kërkuar trajtim më specifik.

Gjatë vitit 2013 kanë funksionuar tetë komitete të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A, duke llogaritur edhe Komisionin e Auditimit. Jo të gjitha komitetet kanë qenë aktive njëkohësisht. Dy prej tyre janë shpërberë, Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet si dhe Komiteti për Asetet.

Nr	**Komiteti**	**Data e formimit**	**Data e shpërbërjes**
1	Komisioni i Auditimit	07.09.2011	Aktiv
2	Komiteti për Staf dhe Shpërblime	25.08.2011	Aktiv
3	Komiteti për Projekte Kapitale	23.10.2012	Aktiv
4	Komiteti për Transportin e Udhëtarëve	04.02.2013	Aktiv
5	Komiteti i Financave 2013	30.05.2013	Aktiv
6	Komiteti për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative	30.05.2013	Aktiv
KOMITETET E SHPËRBËRA			
7	Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet	25.07.2012	30.05.2013
8	Komiteti për Asetet	25.07.2012	30.05.2013

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim një përshkrim të shkurtër për përbërjen e këtyre komiteteve, datën e formimit apo shpërbërjes si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2013:

Komisioni i Auditimit i Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Aksionarit Nr. 01/159 më datë 07.09.2011. Gjatë vitit 2013 Komisioni ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje.

Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komisionit:

Përbërja e Komisionit të Auditimit			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Labinot Halilaj	kryesues	13
2	Heset Cakolli	anëtar	13
3	Shkumbin Hyseni	anëtar	13

Komiteti për Staf dhe Shpërblime i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.08.2011. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 8 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komiteti për Staf dhe Shpërblime			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Shkumbin Hyseni	kryesues	8
2	Hasan Ibraj	anëtar	8
3	Labinot Halilaj	anëtar	8

Komiteti për Projekte Kapitale i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 23.10.2012. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Projekte Kapitale			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Heset Cakolli	kryesues	**11**
2	Hasan Ibraj	anëtar	**11**
3	Shkumbin Hyseni	anëtar	**11**

Komiteti për Transportin e Udhëtarëve i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 04.02.2013. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Transportin e Udhëtarëve			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Labinot Halilaj	kryesues	**7**
2	Shkumbin Hyseni	anëtar	**7**
3	Hasan Ibraj	anëtar	**7**

Komiteti i Financave i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.05.2013. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit të Financave			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	kryesues	**6**
2	Labinot Halilaj	anëtar	**6**
3	Heset Cakolli	anëtar	**6**

Komiteti për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.05.2013. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Shkumbin Hyseni	kryesues	6
2	Labinot Halilaj	anëtar	6
3	Hasan Ibraj	anëtar	6
4	Heset Cakolli	Anëtar nga 27.08.2013	4

- *Në pjesën në vijim janë pasqyruar edhe dy komitetet të cilat kanë arritur t'i përmbushin objektivat dhe qëllimin për të cilin janë formuar dhe janë shpërbërë gjatë vitit 2013:*

Komiteti për Asete i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.07.2012 dhe ka funksionuar deri më 30.05.2013 Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Vlen të theksohet se ky komitet ka bërë një punë të jashtëzakonshme në definimin e çështjeve problematike lidhur me asetet, probleme të trashëguara që nga ndarja e HK-së e tutje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Asete			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	kryesues	5
2	Heset Cakolli	anëtar	5
3	Labinot Halilaj	anëtar	5

Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.07.2012, dhe ka funksionuar deri më 30.05.2013. Gjatë vitit 2013 Komiteti ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje. Po ashtu edhe ky komitet ka trajtuar shumë çështje problematike dhe ka bërë një punë të jashtëzakonshme në definimin e çështjeve lidhur me të arkëtueshmet dhe të pagueshmet. Për këto çështje problematike të trashëguara që nga ndarja e HK-së kemi pasur edhe rekomandimet nga Auditori i Jashtëm të cilat pothuajse veç kanë marrë zgjidhjen e duhur. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Labinot Halilaj	kryesues	3
2	Shkumbin Hyseni	anëtar	3
3	Hasan Ibraj	anëtar	3
4	Heset Cakolli	anëtar	3

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A
Mr.Sc. Hasan Ibraj - Kryesues

3 RAPORT I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

3.1 FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Nga viti në vit Trainkos Sh.A po shënon ngritje të kapaciteteve në të gjitha drejtimet. Viti 2013, që sapo e kemi përmbyllur, ndërmarrjes Trainkos Sh.A, i solli një stabilitet më të lartë dhe i krijoi një bazë më të qëndrueshme për të ardhmen. Periudha që lamë pas, përkatësisht viti 2013, është viti që solli ndryshime në organizimin ndërmarrjes, është periudha e cila karakterizohet me shtim të transportit, rritje të masave të kontrollit dhe kursime të jashtëzakonshme.

Gjatë gjithë vitit 2013 është punuar në drejtim të përafrimit dhe kompletimit të infrastrukturës ligjore, strukturimit, llojllojshmërisë së shërbimeve, kufizim shpenzimesh etj. Këto e kanë bërë operimin dhe performancën të suksesshme. Ishte angazhim maksimal i tërë stafit, Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit dhe të tërë punonjësve ajo që e bëri të mundur përmbylljen e suksesshme të këtij viti.

Kompania edhe vitin 2013 e ka filluar me aktet bazë të miratuar (Planin e Biznesit, Planin e Buxhetit), me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara. Edhe gjatë kësaj periudhe kompania është përball me disa faktorë të cilët kanë ndikuar dukshëm në ecurinë e realizimit të planit operativ dhe financiar të kompanisë. Trainkos Sh.A megjithëse është një kompani e re e posa themeluar dhe përkundër barrierave, e cila filloi punën me kapacitete të pakompletuara tërësisht, arriti të përmbushë pritjet më optimiste për këtë vit.

Ky vit mund të theksohen se ishte vit i suksesit dhe stabilitetit, gjatë vitit kompania ka tejkaluar planifikimet e Planit të Biznesit. Shpenzimet kanë qenë brenda kufijve të parashikuar, është ngritë transporti i mallrave, është punuar në rregullativën e brendshme, është konsoliduar stafi, ka filluar kompania të pajiset me autorizimet e nevojshme nga ARH-ja. Kjo ka reflektuar me përmbyllje me një fitim të konsiderueshëm për rrethanat në të cilat ka filluar vitin kompania.

Gjatë gjithë vitit 2013 kemi punuar me kujdes të shtuar që të ofrojmë për qytetarët dhe bizneset shërbimet e nevojshme si në transportin e mallrave po ashtu në ngritje të nivelit të shërbimeve në transport të udhëtarëve. Kemi përmbyllur vitin me një rezultat të kënaqshëm operativ duke ruajtur trendin pozitiv të ngritjes së transportit të mallrave përkundër shumë sfidave që kemi pasur me konkurrencën, mjetet lëvizëse të vjetruara dhe kufizimeve të lëvizjeve në linjën funksionale për shkak të gjendjes teknike të infrastrukturës. Po ashtu edhe lidhja me hekurudhat e vendeve tjera vazhdon ende të jetë sfiduese, ku të vetmen lidhje e kemi përmes Maqedonisë dhe kjo në masë të madhe e ka vështirësuar performancën tonë, sidomos atë të transportit të mallrave.

Si ekip kemi marrë përsipër barrën e zhvillimit të një kompanie në një kohë jo të lehtë, ku edhe më tutje nuk është prioritet i parë hekurudha, për shkak të nevojave të shumta që kanë sektorët tjerë të shtetit tonë. Por, përkundër që periudha për të cilën po flasim është periudhë relativisht me sfida, ne kemi arritur që të realizojmë shumë nga detyrat që ia kishim parashtruar vetes në fillim të kësaj periudhe njëvjeçare, përkundër të gjithë faktorëve që kanë mundur negativisht të ndikojnë në performancën tonë.

Angazhimet tona të deritashme kanë të bëjnë edhe me hartimin e politikave strategjike me qëllim të përcaktimit të orientimeve dhe qasjeve biznesore të kompanisë. Këto politika janë plotësisht në përputhje me praktikat më të mira të të bërit biznes dhe synojnë ofrimin e shërbimeve sa më të mira përshtatur me rrethanat në të cilat gjendet Kosova. Me qëllim të arritjes së objektivave tona, jemi të angazhuar në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit si në rrafshin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar për të avancuar edhe më funksionimin e kompanisë.

Trainkos, tanimë është një kompani e organizuar mirë dhe e koncentruar në njësi biznes, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe efektive për bizneset dhe qytetarët. Bizneset e Trainkos Sh.A janë të përqendruara momentalisht në transportin e mallrave, atë të udhëtarëve, mirëmbajtjen e lokomotivave dhe trenave motorikë, mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave si dhe të udhëtarëve. Por, synim jonë është që kompania të zgjerohet edhe në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjeve logjistike që lidhen ngusht me këto veprimtari, me objektiv parësor që të ofrohen pako shërbimesh sa më efektive dhe efikase.

Trainkos Sh.A, gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me projektet për investime kapitale, me qëllim që parkun e mjeteve lëvizëse ta bëjmë sa më shumë funksional, që kryesisht janë kry me mjete tona.

Pas kryerjes së riparimit gjeneral të një lokomotive si dhe riparimit të mesëm të dy trenave motorikë të udhëtarëve me mjete të Buxheti të Qeverisë, të cilët i kemi pranuar këtë vit, do të mund t'u ofrojmë qytetarëve shërbime më efikase dhe më cilësore,

Duke u bazuar në Planin e Biznesit, vitin e ardhshëm synojmë të arrijmë këto objektiva: të kemi rritje të shitjeve në tregun e transportit të mallrave krahasuar me vitin 2012 dhe vitin 2013, në tregun e transportit të udhëtarëve të kemi ngritje të numrit të udhëtarëve, sidomos ngritje të të hyrave, të ofrojmë kushte të mira pune për stafin e Trainkos, të rrisim të hyrat nga mirëmbajtja e vagonëve dhe gdhendja e rrotave si dhe një varg objektivash të cilat janë të përcaktuara qartë nga ne në Planin e Biznesit.

Edhe pse kemi pasur një sukses të kënaqshëm gjatë vitit 2013, ne si kompani përballemi me një numër të rreziqeve, që sidomos vijnë nga tri grupe faktorësh (politikë, teknikë dhe faktorë tjerë të jashtëm):

Faktorët politikë janë ato me të cilët përballet në përgjithësi i tërë shteti ynë. Si pasojë e këtyre problemeve, ne sot të vetmen lidhje me hekurudhat e kemi përmes Maqedonisë që është jo e favorshme për ne. Mandej nga ky grup faktorësh, sfidë më vete është se ne nuk jemi të njohur ndërkombëtarisht si hekurudha.

Në grupin e dytë të rreziqeve janë faktorët teknikë, sidomos numri i vogël i mjeteve lëvizëse, vjetërsia e tyre, kostoja e lartë mirëmbajtjes etj.

Faktorët e tjerë që ne kemi të lidhur fatin tonë janë të shumtë. Infrastruktura e dobët, mos mbulimi i humbjeve në transportin e udhëtarëve sipas ligjeve në fuqi, (ashtu siç parashihet marrëveshja PSO), Ekpozeu i Rrjetit me tarifa shumë të larta, kriza ekonomike etj.

Nëse shikohet në prizëm afatshkurtër, Trainkos është në pozitë të mirë të funksionimit dhe në rrugë të mirë gjithashtu të sigurimit të ecjes së vet drejt suksesit. Kjo nuk do të thotë që ne kemi realizuar çdo detyrë e cila varet prej nesh. Jemi të vetëdijshëm që neve na presin edhe shumë detyra e angazhime të reja të cilat besojmë se do t'i realizojmë, duke u mbështetur edhe në përkrahjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si dhe në mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës. Bashkë mendojmë se do t'ia dalim që të kemi një ngritje të cilësisë të punës sonë dhe përmbushje të vizionit dhe misionit të Trainkos.

Kryeshefi Ekzekutiv
Betim Gjoshi

3.2. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Janë të shumta ngjarjet që na kanë shoqëruar gjatë vitit 2013. Çështje tjetër me rëndësi për vitin 2013 ka qenë aplikimi i Deklaratës së Rrjetit, pra pagesat për qasje në rrjet dhe shërbime tjera që janë paguar duke u bazuar në këtë ekspoze, i cili është shumë më i lartë se i vendeve të rajonit, por përsëri më i favorshëm se sa tarifat paushalle të aplikuara në vitin 2012.

Gjatë vitit 2013 është rritur niveli i bashkëpunimit me ARH–në, ku kompania është pajisur me disa licenca dhe autorizime për Shërbime të Transportit Hekurudhor që ne ofrojmë.
Po ashtu, edhe këtë vit është arritë Marrëveshje me MI për Shërbimet Publike, edhe pse nuk i mbulon gjithë trenat siç e parasheh Ligji për Hekurudhat e Kosovës.

Këtë vit përveç angazhimit për rritje të transportit kemi bërë përpjekje për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe rritje të bashkëpunimit me hekurudhat tjera.
Ngjarje me rëndësi ka qenë nënshkrimi i protokollit me Hekurudhat e Shtetit të Turqisë-TCCD, nga i cili kemi benifite në disa fusha.

Kemi pasur takime me hekurudhat Zvicerane –SBB, ato të Malit të Zi-Montecargo etj.
Këtë vit kemi fituar përmes Ambasadës Holandeze një projekt në programin MMF, nga i cili do përfitojmë konsulencë.

Kemi miratuar shumë akte, në mesin e tyre edhe Politikat e Sigurisë. Kemi bërë shumë përpjekje për t'u anëtarësuar në CIT, OTIF, CER etj. Dhe shumë ngjarje tjera të cilat i kemi prezantuar edhe në raportet tjera periodike.

3.3 PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH.A

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë periudhës janar – dhjetor 2013, duke prezantuar realizimin operativ gjatë kësaj periudhe të vitit 2013 krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë dhe me realizimin e vitit paraprak për të njëjtën periudhë. Po ashtu do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

Transporti i mallrave

Në Sektorin e Transportit të Mallrave, i cili luan rolin kryesore për ne, gjatë periudhës një vjeçare respektivisht nga 01 Janar 2013 deri me 31 dhjetor 2013 kemi pasur këto rezultate:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	01 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013
Realizimi Neto Ton në 2012	747,416.00
Realizimi Neto Ton në 2013	1,002,457.84
Planifikimi Neto Ton në 2013	837,105.92
Dallimi: Realizim 2013 – Realizim 2012	+255,041.84
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2013	+165,351.92
Dallimi: Realizim 2013 – Realizim 2012 (%)	+ 34 %
Dallimi: Realizim 2013 – Planifikim 2013 (%)	+ 20 %

Tabela 1.1

Siç mund të shihet nga tabela 1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth **34 %** më shumë se sa në të njëjtën periudhë vjetore të vitit të kaluar respektivisht nga 01.01.2012 deri më 31.12.2012, si dhe duke tejkaluar sasinë e planifikuar për këtë periudhe për rreth **20 %**.




Figura 1.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1 në aspektin operativ kemi një rritje të konsiderueshme.

Më poshtë të dhënat e vlerave Neto Ton janë të shprehura në të hyra me vlerë Euro.

Përshkrimi - Të hyrat	*01 Janar – 31 Dhjetor 2013*
Realizim shitje të hyra Janar - Dhjetorr 2012	2,442,720.00
Realizim shitje të hyra Janar – Dhjetor 2013	3,034,457.72
Planifikimi Janar – Dhjetor 2013	2,407,919.90
Dallimi realizim 2013 - realizim 2012	591,737.72
Dallimi realizim - planifikim 2013	626,537.82
Dallimi realizim 2013 - realizim 2012	+ 24 %
Dallimi realizim - planifikim 2013	+26%

Tabela 1.2




Figura 1.2

- Ndërsa reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore është arritur të krijohen të hyra për rreth **24 %** më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë, ndërsa kemi tejkaluar planifikimin për **26 %** për periudhën raportuese.

- Ekzistojnë arsye të tejkalimit të planifikimit, fal angazhimit tonë dhe punës së shtuar me klientë, në veçanti Kompaninë New Co Ferronikeli i cili ka shtuar transportin për shkak të ofertave dhe shërbimeve të mira që ne i kemi ofruar, të cilat kanë ndikuar dukshëm në performancën e të hyrave tona.

Të hyrat dhe shpenzimet nga biznesi i transportit të mallrave

Përshkrimi	01 Janar – 31 Dhjetor
Shitjet nga transporti i mallrave	3,034,457.72
Shitjet nga shërbimet tjera të transportit të mallrave	164,118.54
Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	14,589.50
Total shitjet	3,213,165.76
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	1,650,022.10
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	520,162.07
Total shpenzimet	2,170,184.17
Fitimi/humbja operative	+1,042,981.59
Fitimi/humbja %	+48%

Tabela 1.3




Figura 1.3

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një fitim operativ prej **48 %** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:

*Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth **35%** nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

Transporti i udhëtarëve

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore të raportimit ne kemi pasur rezultate relativisht të mira.

Në tabelën më poshtë (2.1) janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2013 me periudhën e njëjtë të vitit 2012, nga del se kemi një rritje minimale te numri i udhëtarëve në këtë vit.

Përshkrimi -Udhëtarë	01 Janar - 31 Dhjetor
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2012	366,537
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2013	369,777
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2013	366,537
Dallimi: 2013 - 2012	+ 3,240
Dallimi: realizim - planifikimi 2013	+ 3,240
Dallimi: 2013 - 2012	+1 %
Dallimi: realizim - planifikimi 2013	+1 %

Tabela 2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore ne kemi pasur një numër të udhëtarëve pothuajse të njëjtë krahasuar me vitin e kaluar si dhe me numrin e planifikuar, me një rritje të lehtë prej 1 %.

Shitje në Transportin e udhëtarëve	01 Janar – 31 Dhjetor
Realizim shitje të hyra 2013	243,131.16
Realizim shitje të hyra 2012	229,844.00
Planifikimi 2013	229,844.00
Dallimi: realizim 2013 - realizim 2012	+ 13,287.16
Dallimi: realizim - planifikim 2013	+ 13,287.16
Dallimi: realizim 2013 - realizim 2012	+5.46%
Dallimi: realizim - planifikim 2013	+5.46%

Tabela 2.2




Figura 2.1

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është arritur të krijohen të hyra nga shitja e biletave për rreth **5.5** % më shumë sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe po ashtu rreth **5.5** % më shumë sesa planifikimi për këtë periudhë.

Arsyeja e rritjes së të hyrave nga biletat qëndron në ngritjen e nivelit të kontrollit të brendshëm duke i detyruar shumë udhëtarë të cilët kanë qenë të parregullt që të marrin bileta edhe pse ende kemi një kategori që nuk marrin bileta, si dhe nga masat tjera që kemi marrë.

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi - Të hyrat	01 Janar – 31 Dhjetor
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	987,593.79
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	243,131.16
Transporti i organizuar i udhëtarëve	7,321.51
Total të hyrat	1,738,046.46
Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve	1,345,731.46
Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve	966,015.28
Total shpenzimet	2,311,746.74
Fitimi / humbja operative ne valute	-573,700.28
Fitimi / humbja %	-33%

Tabela 3.3

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **– 33 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara. E gjithë kjo gjendje është se janë mbuluar obligimet vetëm 6 nga 10 trenat që operojmë.

Vërejtje:

*Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth **65** % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

Sektori i Mirëmbajtjes

Në fushën e Sektorit të mirëmbajtjes së: trenave motorikë, lokomotivave, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit prej 01.01.2013 deri më 31.12.1013 kemi pasur këto rezultate.

Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore:

Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtoret tregon se sa dhe ku shfrytëzohet me tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.
Shërbimi i Mirëmbajtjes së Lokomotivave gjatë periudhës janar-dhjetor ka disponua me fuqi pune prej **17632.5** orë ku:

- **11185** orë, janë shfrytëzua për riparim apo **63.43** % e fondit total të orëve.
- **2313** orë, janë shfrytëzua për punë ndihmëse dhe dytësore apo **13.12**% e fondit total të orëve
- Produktiviteti i tërë ka qenë **76.55**%

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar-dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **13485** orë ku:

- **79629** orë, janë shfrytëzua për riparim apo **59.04** % e fondit total të orëve
- **1414** orë, janë shfrytëzua për punë ndihmëse dhe dytësore apo 10.49% e fondit total të orëve
- Produktiviteti i tërë ka qenë **69.53**%

3.4. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2013
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2013)

1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2013

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2013, kemi një gjendje të kënaqshme financiare dhe operative. Gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

TË HYRAT

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 3,034,457.72€ për periudhën janar - dhjetor 2013. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2013 është 2,407,919.97€ dhe nga kjo rrjedh se kemi realizuar 126.01% nga totali i planifikuar për tërë vitin 2013. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 1,687,997.71€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 184,644.76€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "New Co Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 1,161,815.25€.
Për të prezantuar të hyrat në total sipas linjave të realizuara për transportin e mallrave hyjnë: transporti i mallrave i ndarë sipas klasave (i prezantuar më lart), të hyrat nga kontejnerët.Të hyrat nga RIV-i dhe nga vendosja (janë të specifikuara në pozicionin të hyrat nga shërbimet tjera).

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2013 është realizuar në shumën prej 1,738,046.46€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 987,593.79€, nga të hyrat e planifikuara nga MZHE për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat dhe të hyrat tjera është realizuar në shumën prej 243,131.16€ dhe nga transporti i organizuar 7,321.51. Shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 88.20% krahasuar me planifikimet për tërë vitin 2013. Kjo rezulton pasi të ardhurat e planifikuara nga MI kanë qenë më të vogla se ato të planifikuara me Plan Biznesin e Buxheti për vitin 2013.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2013 kanë arritur shumën prej 178,708.04 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2013 e cila është 55,386.66€ arrin kuotën prej 322.65%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 5,555.00€ dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 158,563.54€. Të hyrat nga dëmtimi i vagonëve 14,589.50€.

Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 1,000,000.00€ për projektet kapitale të parashikuara në vitin 2013, është shfrytëzuar në vlerë prej 152,716.00€ dhe mbetja e pashfrytëzuar nga BK është 847,233.55.

SHPENZIMET

Shpenzimet për periudhën janar - dhjetor 2013, edhe pse kemi tejkalim të planifikimeve operative, shpenzimet janë brenda kufijve të planifikimit ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 2,526,154.97 € nga 2,909,041.62 € të planifikuara për vitin 2013 dhe arrijnë kuotën prej 86.84%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2013

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,504,923.89€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,478,011.94€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 17,911.95€. Në total nëse e krahasojmë periudhën janar – dhjetor me shumën e buxhetuar për tërë vitin në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 106.56%. Kjo ka ardhë si rezultat i angazhimit të fuqisë punëtore, që ka qenë e ndërlidhur me rritjen e transportit të mallrave.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 200,198.91€, kjo shumë është vetëm 60.99% nga shuma prej 328,250.00€ e parashikuar për vitin 2013. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2013.


Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 37.07 %, konkretisht në shumën prej 67,559.40€. Planifikimi vjetor i kësaj kategorie është 182,200.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2013.

TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2013


	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2013	Buxheti i Planifikuar 2013	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor 2012
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	3,034,457.72	2,407,919.90	626,537.82	126.01	2,442,720.00
2	Transporti i udhëtarëve	1,738,046.46	1,970,565.10	-232,518.64	88.20	1,671,162.00
3	Shërbimet tjera	164,118.54	55,386.66	108,731.88	296.31	264,897.00
4	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonëve	14,589.50		14,589.50		
5	Të hyrat tjera jo operative	181,248.09		181,248.09		106,843.00
	Të ardhurat nga grantet	776,571.84		776,571.84		565,717.29
I	TOTAL – TË HYRAT	5,909,032.15	4,433,871.66	1,475,160.49	133.27	5,051,339.29
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	1,264,538.25	1,234,562.60	29,975.65	102.43	1,245,171.00
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	30,168.73	48,755.15	-18,586.42	61.88	18,345.00
3	Inventar dhe pajisje	570.7	75,200.00	-74,629.30	0.76	0.00
4	Material harxhues	0.00	5,300.00	-5,300.00	0.00	1,947.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	98,473.30	234,114.24	-135,640.94	42.06	115,777.00
6	Qasja në binarë	804,494.94	1,006,206.63	-201,711.69	79.95	1,370,690.00
7	Sigurimi i palëve të treta	5,549.14	13,000.00	-7,450.86	42.69	5,400.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	250,595.73	274,903.00	-24,307.27	91.16	214,819.00
9	Shpenzimet e trans.biletave dhe KMSH Infrakos	65,730.55	10,000.00	55,730.55	657.31	85,701.00
10	Blerje/shpenzime të tjera	6,033.63	7,000.00	-966.37	86.19	6,748.00
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	2,526,154.97	2,909,041.62	-382,886.65	86.84	3,064,597.00
	Fitimi (humbja) bruto	3,382,877.18	1,524,829.98	1,858,047.20	221.85	1,986,742.29
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,487,011.94	1,369,220.00	117,791.94	108.60	1,363,015.00
	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	17,911.95	43,000.00	-25,088.05	41.66	19,891.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,504,923.89	1,412,220.00	92,703.89	106.56	1,382,906.00
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	923.86	72,900.00	-71,976.14	1.27	11,305.00
2	Sigurimi fizik – total	39,711.20	36,000.00	3,711.20	110.31	38,590.00
3	Shërbimet tjera	0.00	5,000.00	-5,000.00	0.00	1,351.00
4	Shpenzimet logjistike	38,385.50	4,000.00	34,385.50	959.64	28,900.00
5	Energjia elektrike dhe shërbimet	40,467.61	49,500.00	-9,032.39	81.75	34,629.00

	komunale					
6	**Sigurimi i palëve të treta**	**3,090.82**	**10,000.00**	**-6,909.18**	**30.91**	**5,215.00**
7	**Donacionet e dhëna**	**1,300.00**	**5,000.00**	**-3,700.00**	**26.00**	**893.00**
8	**Marketingu**	**2,747.76**	**44,000.00**	**-41,252.24**	**6.24**	**14,584.00**
9	**Udhëtimet zyrtare**	**20,595.00**	**39,000.00**	**-18,405.00**	**52.81**	**17,602.00**
10	**Telefonat dhe Posta**	**19,781.08**	**25,000.00**	**-5,218.92**	**79.12**	**26,815.00**
11	**Shërbimet bankare**	**1,964.98**	**3,000.00**	**-1,035.02**	**65.50**	**1,418.00**
12	**Tatimet**	**1,390.44**	**5,000.00**	**-3,609.56**	**27.81**	**0.00**
13	**Pajisje elektronike**	**14,165.62**	**29,850.00**	**-15,684.38**	**47.46**	**26,202.00**
14	**Zbritjet e Lejuara**	**15,675.03**		**15,675.03**		**58,151.00**
	TOTAL - Shpenzimet operative	**200,198.90**	**328,250.00**	**-128,051.10**	**60.99**	**265,655.00**
E	**Shpenzimet administrative**					
1	**Mbeturinat dhe shërbimet komunale**					
2	**Inventar dhe pajisje**	**152.29**	**15,000.00**	**-14,847.71**	**1.02**	**2,879.00**
3	**Konsulenca dhe auditimi i jashtëm**	**0.00**	**10,000.00**	**-10,000.00**	**0.00**	**5,588.00**
4	**Material i zyrës**	**12,90.19**	**23,000.00**	**-10,098.81**	**56.09**	**10,532.00**
5	**Material sanitar**	**2,119.22**	**7,500.00**	**-5,380.78**	**28.26**	**1,107.00**
6	**Qiraja për objektet**	**6,409.01**	**10,000.00**	**-3,590.99**	**64.09**	**3,373.00**
7	**Reprezentacioni dhe bufeja**	**9,501.68**	**13,000.00**	**-3,498.32**	**73.09**	**11,410.00**
8	**Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet**	**9,372.70**	**15,000.00**	**-5,627.30**	**62.48**	**36,756.00**
9	**Shpenzimet logjistike**	**4,109.97**	**18,700.00**	**-14,590.03**	**21.98**	**3,3889.00**
10	**Kontingjente**	**22,993.34**	**70,000.00**	**-47,006.66**	**32.85**	**14,768.00**
	TOTAL - shpenzimet administrative	**67,559.40**	**182,200.00**	**-114,640.60**	**37.08**	**90,303.00**
II	**TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)**	**4,298,837.16**	**4,831,711.62**	**-532,874.46**	**88.97**	**4,803,461.00**
III	**Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit**	**1,610,194.99**	**-397,839.96**	**-532,874.4**	**88.97**	**247,8787.29**
F	**Shpenzimet e zhvlerësimit**					
1	**Shpenz. e zhvl. që ndikojnë në koston e shërbimit**	**776,571.84**	**51,245.40**	**725,326.44**	**1,515.40**	**609,090.00**
2	**Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në koston e shërbimit**	**79,731.32**	**36,700.81**	**43,030.51**	**217.25**	**109,636.48**
	TOTAL - shpenzimet e zhvlerësimit	**856,303.16**	**87,946.21**	**768,356.95**	**973.67**	**718,726.48**
G	**Fitimi (humbja) nga veprimtaria**	**753,891.83**	**-485,786.17**	**1,239,678.00**	**-155.19**	**-470,848.79**

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – dhjetor 2013



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – dhjetor 2013



1. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2013)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-13
	PCB nr. 1114-004229-0001-59	196,054.10
	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,989.00
	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	138,262.92
	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	61,031.58
	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	175,500.95
	Totali	**595,838.55**

3.5. PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

Implementimi i Planit të Biznesit për Vitin 2013, në Trainkos Sh.A filloi me mjaft vështirësi për shkak të gjendjes së trashëguar.

Duke ju referuar të hyrave me Planin e Buxhetit 2013, kanë qenë të planifikuara gjithsej 4,433,871.66 ndërsa janë realizuar 5,132,460.31 apo shprehur në % 15.75 më tepër se planifikimi. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për vitin 2013 kanë qenë të planifikuara 4,831,711.62, ndërsa janë realizuar 4,298,837.16 apo shprehur në % , - 11.02 më pak se ato të planifikuara.

3.6. PROJEKTET KAPITALE TË TRAINKOS SH.A

Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Data e nenshkrimit te kontrates	Buxheti I zotuar	Vlera e kontrates	Koment
Shërbimet e shtypjes se formularëve	25.03.2013	7,000.00	3,768.00	Përfunduar
Furnizimi me NiCd bateri për lokomotiva	15.05.2013	10,800.00	11,498.88	Përfunduar
Riparim i pajisjeve te frenimit	24.09.2013	25,000.00	22,910.00	Ne zbatim
Furnizimi me rroba mbrojtëse dhe uniforma	20.05.2013	13,000.00	11,300.00	Ne zbatim
Furnizimi me derivate te naftës	20.02.2013	1,400,000.00	491,112.00	Ne zbatim
Renovimi i pjesshëm i objektit te ish Ambulantes	12.09.2013	82,000.00	81,794.05	Përfunduar
Furnizimi me papuçe frenuese		17,230.00	17,230.00	Përfunduar
Furnizimi me vajra dhe lubrifikante		120,000.00	14,593.00	Ne zbatim
Kontrollimi sistematik i punëtorëve	11.04.2013	7,000.00	6,400.00	Ne zbatim
Furnizimi me thëngjill	20.11.2013	10,828.00	10,828.00	Ne zbatim
Mirëmbajtja e sistemit financiar ALFA	17.12.2013	6,000.00	6,000.00	Ne zbatim
Furnizimi me llamella për TM	25.03.2013	6,000.00	5,130.00	Përfunduar
Hartimi i Projektit për pjesën e mbetur të objektit të ish Ambulantes	11.03.2013	5,000.00	4,681.40	Përfunduar
Furnizimi me radiolidhje		5,000.00	4,580.00	Përfunduar
Furnizimi me filtra për lokomotiva	1308.2013	2,600.00	2,310.00	Përfunduar
Furnizimi me pajisje te teknologjisë informative	18.06.2013	4,000.00	4,000.00	Përfunduar
Furnizimi me bateri për transportin e mallrave	20.11.2013	1,740.00	1,680.00	Përfunduar
Furnizimi me material harxhues për zyre		8,000.00	7,246.50	Përfunduar
Furnizimi me roleta shirit për objektin e administratës	31.10.2013	2,300.00	2,150.00	Përfunduar
Implementimi i Infrastrukturës se teknologjisë informative	30.10.2013	9,000.00	8,352.00	Përfunduar
Sigurimi i palëve te treta	02.12.2013	6,500.00	6,437.00	Përfunduar
Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i mjeteve lëvizëse	08.11.2013	5,000.00	4,845.08	Përfunduar
Furnizimi me material për bife	25.11.2013	9,800.00	9,759.50	Përfunduar
Furnizimi me mobilje (shtretër)	16.12.2013	1,800.00	1,615.50	Përfunduar
Furnizimi me tonerë	16.12.2013	9,100.00	5,312.00	Përfunduar
Furnizimi me printer për punimin e ID kartelave	11.12.2013	1,280.00	1,269.90	Përfunduar
Furnizimi me pjese për motor Caterpillar	23.12.2013	0.00	3,200.67	Përfunduar
Furnizimi me inventar për zyre	30.12.2013	9,900.00	9,834.00	Përfunduar

3.7. PRERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Objektivat ekonomike për vitin 2014

- Objektivi në tregun e transportit të udhëtarëve është që të kemi ngitje të transporti të mallrave:
- Të rrisim shërbimet dhe cilësinë e tyre në transportin hekurudhor, për një zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrjes:
- Anëtarësimin në organizata ndërkombëtare:
- Ngritja vazhdueshme e kapaciteteve teknike dhe resurseve njerëzore;
- Ngritja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me operatorët rajonalë dhe atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor me qëllim të shkëmbimit të përvojave të suksesshme:
- Në shërbimin e mirëmbajtjes së vagonëve të kemi një rritje prej 3% në krahasim me vitin 2013;
- Rritja në transportin e mallrave për 5 % në krahasim me planifikimin për 2013;
- Rritja në transportin e udhëtarëve për 4 % në krahasim me planifikimin për 2013 ;
- Niveli i inkasimit të borxheve (arkëtueshmeve) të mëparshëm të jetë >30%.
- Rritja e llojit të shërbimeve (mirëmbajtje të vagonëve, gdhendje të rrotave, transport të kontejnerëve);

Objektivat tjera të kompanisë për vitin 2014

- Rritja e nivelit profesional-shkollime profesionale
- Krijimi i kushteve më të mira për punë
- Ngritja e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve;
- Përmirësimi i komoditetit për udhëtarët;
- Përmirësimi i gjendjes së parkut lëvizës karshi plotësimit të nevojave operative për mjetet lëvizëse;
- Ripërtëritja e stafit;
- Përmirësimi i strukturës gjinore;
- Promovimi i shërbimeve tona në nivel gjithëpërfshirës;
- Hulumtimi i tregut dhe kuptimi më i mirë i kërkesave në treg;
- Përmirësimi i sistemit të komunikimit brenda dhe me klientë;
- Rritja e efektivitetit në dhënien e shërbimeve;
- Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike;
- Përmirësimi i proceseve të brendshme;

3.8. RREZIQET E SË ARDHMES SË KORPORATËS

Në këtë pjesë ne kemi paraqitur disa nga rreziqet të cilat i kanosen kompanisë sonë në të ardhmen dhe për të cilat duhet punuar që t'i minimizojmë efektet e tyre, të cilat po na përcjellin nga viti në vit:


- Numri i vogël i mjeteve lëvizëse dhe vjetërsia e tyre;
- Mosmbulimi i shpenzimeve të Transportit të Udhëtarëve sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës ;
- Buxheti i vogël për investime kapitale dhe kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat;
- Pamundësia e kontrollit të procesit të ofrimit të shërbimit për transportimin e mallrave të importuara apo të eksportuara vetëm nga ana jonë për shkak të përfshirjes të më shumë operatorëve hekurudhorë në ofrimin e këtij shërbimi;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;
- Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokimi i daljes veriore për në Serbi përmes së cilës do të lidheshim me shtetet tjera të Evropës, por edhe me porte tjera detare.

4 RAPORTI SIPAS LIGJIT PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

4.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A

Skema organizative e Trainkos Sh.A

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. vitin 2013 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2012. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2013 ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në Trainkos Sh.A është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të Trainkos Sh.A më 1 janar 2013 dhe më 31 dhjetor 2013							
Totali i të punësuarve		01.01.2013		31.12.2013			
		213		220			
Mosha mesatare e punëtorëve	01.01.2013	31.12.2013	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
	47.16	47.00	01.01.2013	31.12.2013	01.01.2013	31.12.2013	
Me marrëdhënie të rregullt pune			213	220	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të paafatizuar			87	83	40.34%	37.72%	
Me kontratë të afatizuar			126	137	59.15%	62.27%	
Meshkuj			193	197	94.47%	89.54%	Gjinia
Femra			20	23	9.38%	10.45%	
Serb			2	2	0.93%	0.90 %	Nacionaliteti.
Shqiptarë			211	218	99.06%	99.09%	
Me shkollim fillor			19	18	8.09%	8.18%	Përgatitja shkollore
Me shkollim të mesëm			152	155	71.83%	70.45%	
Me shkollim të lartë			5	4	2.34%	1.81%	
Me shkollim superior			37	43	16.90%	19.54%	
Departamenti i Operimeve			148	140	69.48%	64.54%	
Departamenti i Administratës			33	42	15.49%	20%	Përshkimi i Departamenteve
Zyrtar të larte			4	4	1.87%	1.36%	
Departamenti i Fianancave			5	5	2.34%	2.27%	
Departameti i Zhvillmit			4	6	1.87%	2.72%	
Kabineti i KE-së			4	4	1.87%	1.36%	Kabineti i KE-së dhe Zyret në kuadër të KE-së
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit			12	14	5.63%	6.36%	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun			3	2	1.40%	0.90%	
Zyra e Prokurimit			3	3	1.40%	1.36%	

Vërejtje:
Tabela më lartë nuk përmban anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Sqarim i tabelës të lartëcekur:
Totali i të punësuarve me 01.01.2013 është 213 të punësuar.
Totali i të punësuarve me 31.12.2013 është 220.

4.2. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2013

Gjatë periudhës njëvjeçare Sektori për çështje ligjore dhe resurse njerëzore ka mbajtur gjithsej 49 seanca gjyqësore. Kontestet Gjyqësore janë rreziqet kryesore të kompanisë, sidomos kontestet e punës.

Këto procese janë të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës, si rezultat edhe i mos përfilljes së procedurave dhe kontratave nga menaxhmenti i asaj kohe. Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore funksionon në kuadër të Departamentit të Administratës, me qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të kompanisë. Duke u bazuar në këtë ka ndërmarr të gjitha veprimet në sigurimin e të gjitha provave elementare për ta mbrojtur kompaninë nga paditësit që kanë ngritur padi kundër Trainkos Sh A për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo materiale duke u bazuar në aktet normative të aplikueshme në Trainkos Sh A si dhe në propozimin e nxjerrjes së provave përmes ekspertizave dhe superekspertizave në rastet e mungesës së disa provave me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë – kontributit të pjesëmarrësve në komunikacionin hekurudhor dhe zgjidhjes së këtyre kontesteve në favor të kompanisë. Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale nga zyrtarët ligjorë të Kompanisë.

4.3. KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2014

Hekurudhat e Kosovës Trainkos SH.A në vitin 2014 pritet të ballafaqohen me 42 konteste gjyqësore që nga procedura fillestare e deri te revizioni. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2014:

Kategoritë e kontesteve	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	16
Kontestet për kompensim të dëmit	17
Kontestet për pagim të borxhit	5
Penale	4

Në bazë të kësaj gjendje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me një vlerë të lartë financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi I UNMIK-ut.

4.4. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR- DHJETOR 2013

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2013	422,472.03€
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2013	4,600,654.32€
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2013	4,374,236.32€
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2013	196,054.1€
Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2013	8,842.16€
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2013	152,716.45€
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2013	23,295.69€
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2013	138,262.92€

5 PËRFUNDIM

Është fat që këtë vit e kemi me bilanc pozitiv në të gjitha fushat që varen nga angazhimi i stafit të Kompanisë. E gjithë kjo ka rezultuar me mbylljen e vitit me një fitim dhe me tejkalime pozitive të planit të biznesit në të gjitha objektivat.

Kjo gjendje pozitive ka ardhë si rezultat i dy faktorëve. Në grupin e parë të faktorëve bëjnë pjesë masat që janë ndërmarr përmes politikave të Bordit të Drejtorëve, angazhimeve të menaxhmentit në rritje të të hyrave dhe kujdesit të stafit për zhvillim të kompanisë. Ndërsa në grupin tjetër bëjnë pjesë faktorët që kanë ndikuar në uljen e shpenzimeve. Në këtë grup hynë rritja e kontrollit administrativo-financiar, masat e kontrollit, menaxhim më i mirë në fushën e operimeve, planifikim më i mirë transporti, planifikimi i kujdesshëm i shpenzimeve dhe nevojave. ***Vlen të theksohen se kufizimit e shpenzimeve kanë qenë drastike dhe janë plotësuar vetëm nevojat që kanë ndikuar direkt në operim.***

Jemi munduar që duke ofruar zgjedhje konkurruese të transportit të jemi zgjedhja e parë për transportin e rëndë. Kemi ndërtuar vizonin tonë në bazë të analizave që kemi bërë dhe në bazë të këtij vizoni mendojmë të jemi prijës në transportin e mallrave e sidomos të industrive të rënda brenda vendit me një rritje të vazhdueshme për t'u zgjeruar në rajon si dhe me shërbime konkurruese, komode dhe me saktësi të lartë të jemi zgjedhja e parë e udhëtimit për pjesën më të madhe të qytetarëve të vendit

Për të realizuar të gjitha objektivat kërkohet angazhim i shtuar. Ne po i bëjmë të gjithë hapat e nevojshëm për ta përmbushur këtë në të ardhmen duke u siguruar në një angazhim të madh të stafit menaxherial e profesional.

Në vitin 2013 fokusi ynë ka qenë orientimi në plotësimin e detyrimeve tona karshi klientëve tanë si dhe publikut të gjerë. Duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme të klientëve tanë, meqenëse shërbimet tona i drejtohen më shumë se një tregu, ne i kemi ndërlidhur disa detyrime bazë që mendojmë t'i mbajmë drejt secilës kategori të qytetarëve. Transparenca, korrektësia dhe trajtimi jo diskriminues do të jenë detyrimet më karakteristike të punës sonë. Sikur në ofrimin e shërbimeve të transportit të mallrave apo udhëtarëve po ashtu edhe në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse. Angazhimet tona drejt këtyre detyrimeve do të shtohen edhe më shumë në të ardhmen me qëllim që konsumatorët tanë të jenë të kënaqur me raportin me ne si partner të tyre.

Siç u pa më lart, në këtë raport u prezantuan në mënyrë të përmbledhur përveç pasqyrës së aktiviteteve tona të përfunduara gjithashtu edhe synimet tona për të ardhmen e kompanisë. Besojmë se do të arrijmë që këto synime t'i përmbushim në një të ardhme të afërt, bazuar në misionin dhe në vizionin e Trainkos dhe gjithsesi se do të avancojmë tutje.

Në përfundim mund të themi se gjatë vitit 2013 kemi përmbushur objektivat tona operative dhe veçmas ato financiare duke tejkaluar planifikimet për rreth 33.27% dhe si rrjedhojë kompania ka përmbyllur vitin 2013 me fitime. Ky sukses i arritur në vitit 2013 është një tregues se strategjia jonë po tregon rezultate pozitive dhe për këtë një meritë të jashtëzakonshme e ka i gjithë stafi i kompanisë.

Mars 2013

Betim Gjoshi

Kryeshef Ekzekutiv i Trainkos Sh.A